



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 10.05.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 06.05.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik, **Grup i Operatoreve Ekonomik "Ledi Ing" & "Ledi Ing-2" shpk nga Shtimja**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i shtratit të lumit në Ribar i Madh" me Nr. të Prok: 613-22-1788-5-2-1

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Grup i Operatoreve Ekonomik "Ledi Ing" & "Ledi Ing-2" shpk nga Shtimja** të dt. 06.05.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të lumit në Ribar i Madh", me nr. të Prok: 613-22-1788-5-2-1

Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë për Operatorin Ekonomik **Grup i Operatoreve Ekonomik "Gurëbardhi" shpk & "Benita Company" shpk nga Klina**. Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 28.04.2022

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **Grup i Operatoreve Ekonomik "Ledi Ing" & "Ledi Ing-2" shpk nga Shtimja**, me datë 06.05.2022 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të lumit në Ribar i Madh" me nr. të Prok: 613-22-1788-5-2-1 ku këtë aktivitet AK ka shpallur fitues **Grup i Operatoreve Ekonomik "Gurëbardhi" shpk & "Benita Company" shpk nga Klina** për shpërblim me kontratë të datës 28.04.2022 dhe ka publikuar në platformën elektronike e-prokurimi.

Operatori Ekonomik Grup i Operatoreve Ekonomik "Ledi Ing" & "Ledi Ing-2" shpk nga Shtimja me datë. 06.05.2022 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shtratit të lumit në Ribar i Madh" Autoriteti Kontraktues, me datë 10.05.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Në bazë të "Rregullave për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave", neni 4 pika b në të cilin thuhet: Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te nje konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.

Dhë në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 5 për kalkulimin e afateve kohore pika 1 dhe 2 në të cilët thuhet:

Pika 1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

Pika 2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj

Në bazë të këtyre rregullave dhe Ligjit të prokurimit publik ju keni paraqitur kërkesë për rishqyrtim jashtë afatit ligjor, përkatësisht këtë kërkesë për rishqyrtim e keni paraqitur në ditën e 8 pas orës 16:00 apo më saktë në ora 15:07 dhe si e tillë kërkesa për rishqyrtim hudhet poshtë.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani


Drejtör i Prokurimit